

Organization for Security and Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

**RAPORT REAGIMI: PËRGJIGJET NDAJ RASTEVE
TË DHUNËS NË FAMILJE DUKE MARRË PARASYSH
VDEKJEN E ZNJ. ZEJNEPE BYTYÇI-BERISHA**

Hyrje

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) është e shqetësuar për rastin e vrasjes së Znj. Zejnepe Bytyçi-Berisha dhe ka përpiluar këtë raport për të nënvizuar nevojën urgjente për zbatimin e plotë të kornizës ligjore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në Kosovë. OSBE-ja ka shfaqur edhe më herët shqetësimet lidhur me implementimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDhF).¹ Ky raport nënvizon prapavijën e rastit të Znj. Bytyçi-Berisha. Më pas raporti përcjellet me shqyrtimin e obligimeve të Kosovës sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe detyrat e obligimet të Policisë së Kosovës dhe prokurorisë lidhur me dhunën në familje. Raporti përfundon me një numër rekomandimesh për të adresuar çështjen e dhunës në familje në Kosovë.

Prapavija e rastit

Një grua - Znj. Zejnepe Bytyçi-Berisha – është therrur për vdekje me 23 tetor 2015 – me gjasë nga bashkëshorti vet, pas disa viteve të të qenit e nënshtruar ndaj ushtrimit të dhunës në familje. Bashkëshorti i Znj. Bytyçi-Berisha ka histori të sjelljes kriminale dhe të ushtrimit të dhunës në familje. Në vitin 2002, bashkëshorti i Znj. Bytyçi-Berisha ishte shpallur fajtorë për vepër të dhunshme të kryer ndaj saj, dhe i ishte shqiptuar dënim me burg – me kusht për 6 muaj.² Në vitin 2008, në një incident të ndarë – jo lidhur me dhunën në familje – bashkëshorti i Znj. Bytyçi-Berisha ishte dënuar me gjobë prej €300 për veprën penale – posedim i paautorizuar i armëve.

Në vitin 2012, Znj. Bytyçi-Berisha tentoi të kryente vetëvrasje. Policia hapi hetimet lidhur me tentim-vetëvrasjen për të vlerësuar se a ka pasur, apo jo, sjellje kriminale. Në deklaratimet e saj të asaj kohe, Znj. Bytyçi-Berisha kishte thënë se i ka raportuar në polici incidentet e dhunës në familje, në shtatë apo tetë raste të ndara, të kryera nga bashkëshorti i saj kundër saj dhe vajzës së tyre 11 vjeçare. Asgjë nuk ishte ndërmarrë nga policia për këtë, kishte theksuar ajo. Më tej, ajo kishte deklaruar se përgjatë viteve, ajo vazhdimisht i është nënshtruar dhunës fizike të kryer nga bashkëshorti i saj, dhe një ditë para tentim-vetëvrasjes, ai kishte ushtruar dhunë fizike ndaj vajzës së tyre. Në shkresat e lëndës të hetimeve për këtë rast, ka fotografi që e bëjnë të qartë se vajza e saj kishte pësuar lëndime fizike. Siç kishte sqaruar Znj. Bytyçi-Berisha në deklaratimet e saj, tentimi i saj për të kryer vetëvrasje ishte bërë pjesërisht nga besimi i saj se nuk ka pasur nga t'ia mbajë. Tentim-vetëvrasja duket të ketë qenë përpjekja e saj e fundit për të kërkuar ndihmën e autoriteteve.

Pasi që arriti në përfundim se Znj. Bytyçi-Berisha me të vërtetë kishte tentuar të kryejë vetëvrasje, dhe për këtë edhe lëndimet ishin shkaktuar nga vet ajo, policia vendosi se rasti duhet të mbyllet. Shkresat e lëndës ishin dërguar tek prokurori, i cili nuk ndërmorri asnjë veprim. Përkundër tentimit të saj për të kryer vetëvrasje, historisë së bashkëshortit të saj të ushtrimit të dhunës në familje dhe sjelljeve tjera kriminale, si dhe dëshmime fotografike dhe të raportuara të dhunës në familje në shtëpinë e Znj. Bytyçi-Berisha, duket se në asnjërin nga këto pika as policia e as prokuroria nuk ndërmorrën asnjë hap të mëtutjeshëm relevant. Veprimet e tilla është dashur të përfshijnë: hapjen e hetimeve lidhur me dhunën në familje në

¹ OSBE, *Raport Reagimi: Urdhërat për Mbrojtje Emergjente në Rastet e Dhunës në Familje* (qershor); shih po ashtu Raportin e OSBE-së, *Gjykimi i kërkesave për urdhra për mbrojtje në rastet e dhunës në familje në Kosovë* (mars 2012), fq. 22.

² Në vitin 2003, Znj. Bytyçi-Berisha dha deklaratë pranë Qendrës për Punë Sociale – e cila i ofronte asistencë sociale familjes së saj – duke thënë se nuk kishte më sfida në ambientin e shtëpisë e saj dhe se gjendja me bashkëshortin e saj ishte normalizuar.

shtëpinë e Znj. Bytyçi-Berisha; udhëzimin e Znj. Bytyçi-Berisha se ajo mund të kërkojë lëshimin e urdhërit mbrojtës nga gjykata, të paraparë me Nenin 13 dh 14 të LMDhF; dhe referimin e menjëhershëm të rastit tek Njësia për Mbrojtjen e Viktimave³ që vepron në kuadër të prokurorisë dhe është e autorizuar të parashtojë kërkesë për lëshimin e urdhërit mbrojtës për viktimat e dhunës në familje, me pëlqimin e viktimës, apo ta referojë tek Qendrat për Punë Sociale (QPS), që lejohen të kërkojë urdhërin mbrojtës për të miturit.⁴

QPS-ja në Suharekë/Suva Reka i kishte pranuar nga policia shkresat e lëndës lidhur me tentim-vetëvrasjen e Znj.Bytyçi-Berisha; por tek pas tre javëve. QPS-ja e kishte të njohur viktimën dhe familjen e saj për disa vjetë pasi që ajo dhe bashkëshorti i saj ishin përfitues të asistencës sociale, dhe në vitin 2000 ishin njoftuar se bashkëshorti i viktimës kishte ushtruar dhunë kundër saj. Në një intervistë të zhvilluar në nëntor 2015, OSBE është njoftuar se QPS-ja i ka ofruar ndihmë vajzës së viktimës pas incidentit të vitit 2012. Megjithatë, kjo ndihmë nuk ishte dokumentuar dhe OSBE nuk ka mundur të gjejë asnjë dëshmi që do të tregonte se është parashtruar kërkesë për lëshimin e urdhërit mbrojtës për vajzën e saj.

Obligimet sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)

Ka praktikë të bollshme nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut që thekson obligimin pozitiv të autoriteteve për t'i mbrojtur individët nga dhuna në familje, bazuar në Nenin 2 (e drejta për jetë), Nenin 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimin ç'njëzëzor e degradues) dhe Nenin 8 (respekti për jetën private dhe të familjes).⁵ Shetet kanë "detyrë primare për të mbrojtur të drejtën për jetë, duke i vendosur dispozitat efektive të ligjit penal për të dekurajuar kryerjen e veprave kundër personit, të cilat fuqizohen me makineri të zbatuesve të ligjit për parandalimin, luftimin dhe dënimin për shkelje të dispozitave të tilla".⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është drejtëpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë, andaj obligimet e njejta pozitive bien mbi institucionet e Kosovës.⁷ Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, për t'u ngritur çështja e obligimit pozitiv, duhet të vendoset që institucionet, kanë ditur apo është dashur të dijnë në kohën e ekzistimit të rrezikut të vërtetë dhe të menjëhershëm të jetës së një individi të identifikuar, nga veprat kriminale të palës së tretë, megjithatë dështuan të ndërmarin masat nga fushëveprimi i kompetencave të tyre, të cilat po që se gjykohen me arsyeshmëri mund të jenë pritur nga ta në mënyrë që të shmanget rreziku.⁸ Bazuar në informacionin me të cilin disponon OSBE, në vitin 2012 Policia dhe Prokuroria e Kosovës kanë dështura të marrin masa arsyeshme ndaj asaj që me gjasë ka qenë kërcënim i vërtetë dhe i menjëhershëm për jetën e Znj. Bytyçi-Berisha.

Përgjegjësitë e Policisë dhe Prokurorisë së Kosovës

Në Kosovë, kur një incident i dhunës në familje raportohet në polici, policia ka obligime të veçanta sipas LMDhF-së për ta mbrojtur viktimën dhe për ta parandaluar dhunën e mëtejshme. Sipas LMDhF-së, Policia e Kosovës do t'i përgjigjet çfarëdo raportimi për

³ Ligji Nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, 10 gusht 2010

⁴ Shih Nenin 13 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, fusnota e sipërme 3.

⁵ Shih Nenin 2 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Fundamentale KEDNj. Fjalja e parë e Nenit 2(1) i Konventës e detyron Shtetin jo vetëm të mos merr jetë me qëllim, dhe në mënyrë të paligjshme por edhe të merr hapa të nevojshëm për të mbrojtur jetët e atyre brenda juridiksionit të vet (*shih GjEDNj, L.C.B kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 qershor 1998, paragrafi 36).

⁶ GjEDNj, *Kontrova kundër Sllovakisë (7510/04)*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 31 maj 2007, paragrafi 49.

⁷ Neni 22 i kushtetutës, 15 qershor 2008. Shih po ashtu Nenin 53 të kushtetutës që i jep mbizotërim standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁸ GjEDNj, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 tetor 1998, paragrafi 116, dhe *Kontrova kundër Sllovakisë, fusnota e sipërme 6*, paragrafi 49.

dhunë në familje, apo kërcënimeve të kryerjes së veprave të tilla.⁹ Sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë (PSV për Dhunën në Familje) të publikuara në vitin 2013: Policia e Kosovës, si “reaguesit e parë të zakonshëm kanë një detyrim për të dhënë informacion viktimave, t’i udhëzojnë viktimat gjatë procesit dhe të njoftojnë akterët tjerë.” Si reaguese e parë, nga policia kërkohet jo vetëm të hetojë sjelljen e mundshme penale, por edhe të përdorë mjete të arsyeshme për ta mbrojtur viktimën siç janë: ta njoftojë viktimën për të drejtat e tij/saj përfshirë të drejtën për të kërkuar urdhër për mbrojtje emergjente në bazë të Nenit 13 të LMDhF-së që e obligon gjykatën të vendos lidhur me të brenda afatit prej 24 orëve; ta njoftojë viktimën për shërbimet në dispozicion që ofrojnë ndihmë ligjore, psikologjike dhe të tjera; dhe t’i njoftojë menjëherë akterët tjerë relevant, përfshirë Njësinë për Mbrojtjen e Viktimave dhe QPS-në, veçanërisht nëse ka fëmijë të përfshirë.¹⁰ Policia po ashtu duhet të përpilojë raportin e incidentit, pavarësisht është kryer apo jo vepra penale, dhe t’ja jap viktimës një kopje të saj.¹¹

Përpos sigurimit të mbrojtjes së viktimës, policia është e obliguar sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP)¹² të ndërmerr një numër veprimesh për t’i sjellur kryesit e dhunës në familje para drejtësisë. Pasi të ketë pranuar informacionin për dyshimin e kryerjes së veprës penale, policia është e obliguar që të kryejë hetimet për të vendosur nëse ka bazë për ndjekje penale dhe të ndërmerr të gjithë hapat e domosdoshëm për të mbledhur informacionin relevant që mund të jetë i dobishëm gjatë procedurës penale. Bazuar në informacionin dhe dëshmitë e mbledhura, nëse ka dyshim të arsyeshëm që është kryer një vepër penale, policia duhet të përpilojë kallëzimin penal dhe ta dorëzojë atë në prokurori. Nëse policia ka gjetur se nuk ka pasur kryerje të veprës penale, ajo ka për obligim që ta dërgojë një raport të veçantë te prokurori, që sqaron se nuk ka bazë për kallëzim penal.¹³

Gjatë këtyre hapave fillestar të hetimit, policia dhe prokuroria punojnë së bashku, mirëpo policia ka më shumë autonomi sipas KPP-së, ndërsa sipas Kodit të mëparshëm të Përkohshëm të Procedurës Penale KPPP¹⁴, hapat fillestar të hetimit ishin përgjegjësi e prokurorit.¹⁵ Me pranimin e kallëzimit penal, prokurori ka disa mundësi në dispozicion: mund ta hedh poshtë kallëzimin penal; të kërkojë nga policia informata shtesë nëse ato që janë ofruar janë të pamjaftueshme; inicoj hetimin mbi bazën e kallëzimit penal; apo menjëherë të ngrit aktakuzë.¹⁶ Nëse prokurorit i bëhet me dije ekzistimi i provave lidhur me kryerjen e një vepre tjetër penale gjatë hetimeve, ai ose ajo mund të inicoj një hetim të veprës tjetër penale apo të zgjerojë hetimet aktuale.¹⁷ Dhuna në Familje nuk është vepër e veçantë penale sipas Kodit Penal.¹⁸ Rastet e dhunës në familje zakonisht cilësohen si “Lëndim i Lehtë Trupor” të kryera ndaj “viktims së ndjeshme” sipas Nenit 188(3) të Kodit Penal. Vlenë të theksohet se prokurorët kanë për detyrë të hetojnë dhe të ndjekin disa vepra penale *ex officio*.¹⁹

⁹ Shih Nenin 24(1) të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, fusnota e sipërme 3.

¹⁰ Shih Nenin 24(3) dhe (4), *ibid*.

¹¹ Shih Neni 24(4), *ibid*.

¹² Kodi N3. 04.L-123 për Procedurën Penale, 1 janar 2013.

¹³ Shih Nenet 69(1), 70(2), 81(1) dhe (4), *ibid*.

¹⁴ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003.

¹⁵ Shih Nenin 70(2) KPP dhe Nenin 200(2) dhe (3) KPPP. *Shih gjithashtu* Udhëzuesin e KPP-së, fq. 45.

¹⁶ Shih Nenin 83 dhe 101(2) KPP. Prokurorët kanë pasur të njëjtat detyra me KPPP (*shih* nenet 208-209 KPPP).

¹⁷ Shih Neni 103(4) KPP (*shih* neni 222(2) KPPP).

¹⁸ Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Kosovës, 1 janar 2013.

¹⁹ Shih Nenin 49 KPP (*shih* Nenin 6 KPPP). Disa raste të dhunë në familje nuk ndërlidhen me dhunë fizike por me kërcënim për kryerje të saj. Hetimi i kërcënimit si vepër penale sipas Nenit 185 të Kodit Penal inicohet me propozimin e palës së dëmtuar.

Përfundim

Në kundërshtim me kornizën ligjore të zbatueshme në Kosovë – duke përfshirë edhe standardet ndërkombëtare të ngërthyera në të – asnjë nga hapat që parashihen me KPP apo LMDhF nuk duket se janë ndërmarrë nga policia apo prokuroria në rastin e Znj. Bytyçi-Berisha. Si Znj. Bytyçi-Berisha ashtu edhe vajza e saj duket se janë lënë pa asnjë mbrojtje që parashihet me ligjin për viktimat e dhunës në familje edhe pse policia dhe QPS kishin njohuri për të kaluarën e dhunshme të bashkëshortit të Znj. Bytyçi-Berisha. Sipas provave në shkresat e lëndës për hetimet e rastit të vetëvrasjes në tentativë të Znj. Bytyçi-Berisha, policia gjithashtu kishte bazë për ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm që dhuna në familje ishte duke ndodhur. Nuk duket të jetë ndërmarrë ndonjë hap adekuat nga policia apo prokuroria për të hetuar veprimet potenciale kriminale të bashkëshortit të Znj. Bytyçi-Berisha. Pas dënimit të vitit 2002 asnjë kallëzim penal për dhunë në familje nuk është ngritur ndaj bashkëshortit të Znj. Bytyçi-Berisha. Duket se institucionet relevante kanë marrë rol dhe përgjegjësi të kufizuar, duke u fokusuar më tepër në hetimin – me fjalë tjera, në përcaktimin e asaj se nëse vetëvrasja në tentativë ka qenë e vet shkaktuar – në vend se t'i përgjigjen në mënyrë të tërësishme çështjes më të gjerë të dhunës në familje, dhe të përcjellin me hetim të veçantë gjasat e dhunës në familje.

OSBE konsideron se ky rast nuk është i vetmi ku institucionet kanë dështuar që të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme ndaj incidenteve të dhunës në familje. OSBE rregullisht i monitoron rastet në të cilat viktimat kërkojnë urdhra mbrojtës, mbi bazën se i janë nënshtruar dhunës në familje apo kërcënimeve, fizike apo psikologjike; me fjalë tjera, mbi bazën e cila tregon për veprime kriminale nga ana e të pandehurit. Në këto raste, OSBE rrallë ka vërejtur se në mënyrë paralele është inicuar edhe procedura penale ndaj kryesit, edhe në rastet ku urdhri për mbrojtje është lëshuar dhe rrjedhimisht ka ekzistuar dyshimi i bazuar për veprime kriminale.²⁰ Kjo mund të tregojë për një dështim në koordinim adekuat dhe në qasje të tërësishme të institucioneve relevante të përfshiera në reagimin ndaj rasteve të dhunës në familje, duke siguruar mbrojtjen për viktimën dhe dënimin për kryesin. Si shembull, OSBE ka vërejtur se urdhrat për mbrojtje nuk përcillen në mënyrë adekuate (për shembull, nga policia apo Njësia për Mbrojtje të Viktimave) në mënyrë që të sigurohet se procedura penale ngritet sapo të përcaktohet dyshimi i arsyeshëm.²¹ Ngjashëm, diskutimet me stafin e QPS në vitin 2015 tregojnë se QPS ka qenë fillimisht e informuar nga gjykata e jo nga Policia e Kosovës, për rastet e dhunës në familje. Si rezultat, nuk duket se policia është duke e kryer në mënyrë konsistente rolin e reaguesit të parë siç është paraparë me PSV-të e Dhunës në Familje, për të “udhëzuar viktimat për procedurën dhe informimin e akterëve tjerë [Sic].” Përfundimisht, OSBE ka vërejtur se vazhdojnë vonesat në caktimin e seancave sipas kërkesave për urdhra për mbrojtje emergjente në rastet e dhunës në familje. Në vetëm 7 nga

²⁰ OSBE ka monitoruar 94 raste civile mes vitit 2013 dhe 2015 (13 nga të cilat ishin kërkesa për urdhëra mbrojtës emergjent) në të cilat viktimat ka kërkuar urdhërmbrojtje nga gjykata mbi bazën se i janë nënshtruar dhunës apo kërcënimeve për dhunë në familje. Në vetëm 28 raste janë ngritur kallzime penale nga policia ndaj të pandehurve lidhur me dyshimin për kryerjen e veprave të dhunës në familje.

²¹ *Shih gjithashtu Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, Reagimi i Policisë dhe Prokurorisë ndaj Rasteve të Dhunës në Familje në Kosovë (2015), faqe 51-53* (ku prezentohet një rast studimi, rasti ‘X’, ku paraqitet një seri e veprimeve abuzive që kanë ndodhur në kontekstin e një raporti familjar. Në gusht 2014, i pandehuri me gjasë e ka sulmuar viktimën në vend publik. Policia e Kosovës nuk kanë ngritur kallzim penal për këtë incident dhe prokuroria nuk ka ngritur aktakuzë në lidhje me këtë incident. Tutje, gjyqtari i lëmisë civile i cili është intervistuar ka deklaruar se “nuk informohet nëse procedura civile dhe penale lidhur me viktimën e njejtë dhe kryesin e dyshuar zhvillohen në të njejtën kohë”) shih: http://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Libri_Final.pdf.

13 raste të monitoruara mes 2013 dhe 2015, urdhërmbrojtjet emergjente ishin lëshuar brenda afatit të detyrueshëm prej 24 orëve.

Rekomandime

- Në pajtim me obligimet e saj sipas kornizës ligjore të Kosovës, Policia duhet t'i hetojë ankesat lidhur me dhunën në familje dhe të parashtojë kallëzimin penal në prokurori nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepër penale;
- Prokurorët duhet të shqyrtojnë edhe më tej dhe të marrin parasysh me kujdes rastet e dhunës në familje, në rastet ku policia nuk e ka konsideruar se procedura penale duhet të inicohet;
- Policia e Kosovës, prokurorët, Mbrojtësit e Viktimave, QPS-të dhe gjykatat duhet të përmirësojnë bashkëpunimin në mënyrë që të sigurohen se viktimat e dhunës në familje marrin mbrojtjen e nevojshme, dhe se të pandehurit ballafaqohen me procedurën penale;
- Policia e Kosovës duhet menjëherë të informojë QPS-në për rastet e dhunës në familje, në veçanti kur ka të përfshirë fëmijë, dhe gjithashtu duhet të informojë Njësinë për Mbrojtësit e Viktimave;
- Të shqyrtohet zbatimi i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, për të siguruar se ekzistojnë mekanizma efektiv të koordinimit për t'i ndihmuar viktimat e dhunës në familje
- Gjykatat duhet t'i përmbahen afatit 24-orësh lidhur me vendosjen për urdhëra për mbrojtje emergjente.